



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS
MBAJTUR MË DATË 23.05.2002

Seanca u mbajt në sallën e Kuvendit dhe filloi në ora 10.00, të njëjten e kryesoi kryetari z. Nexhat Daci, gjithashtu në seancë ishte e pranishme edhe Kryesia e Kuvendit në përbërje të plotë:

Në seancë ishte i pranishëm ushtruesi i detyres së Sekretarit të Kuvendit z. Frank Boulin.

Për këtë séance u propozua ky:

REND DITE:

Shqyrtimi dhe aprovimi I procesverbalit nga seanca e kaluar

Vazhdimi I séances së kaluar

Rendi I ditës njëzërit u aprovua nga të pranishmit.

Seancën e hapi kryetari I Kuvendit të Kosovës z. Nexhat Daci, I cili përshendeti deputet dhe I njoftoi se kan arritë dy letra , një nga Keshilli I Sigurimit dhe tjetra nga Bashkësia Evropiane.

z.Nexhat Daci: Propozon dhe jep një pauzë deputetëve deri në ora 11.30, që të kenë mundesi grupet parlamentare ti harmonizojn qendrimet e tyre dhe pas kesaj të vazhdohet seanca plenare.

Seanca plenare vazhdoi punimet më një vonesë prej 30 minutave.

Kryetari I Kuvendit njoftoi deputetet se edhe pas takimeve të grupeve parlamentare për qendrimin e Kryesisn së Kuvendit janë të pandryshuara, rreth aprovimit të Projektrezolutes të hartuar nga dy Komisionet , Komisini Legjislativ dhe ai I bashkpunimit Nderkobëtar

Kryetari fton udhëheqesit e grupeve parlamentareqe ta marrin fjalën dhe ti shprehin qendrimet e tyre rreth Projektrezolutes se hartuar nga dy Komisionet.

I pari e mori fjalen kryetari I grupit parlamentar i LDK-së
z.Sabri Hamiti, theksoi : se ne kemi mbajtur mbledhje , dhe një zërit jemi qe kjo projek rezulut te qitet ne votim dhe të votohet .

Jemi te bindur se kemi kopetenca ti mbrojmi interesat tona dhe nuk paraqet ndonjë konfrontim me UNMIK-un ,dhe as qe e dëshirojmë .

z.Nexhat Daci ,fton : grupin parlamentar të PDK-es ta marr fjalen.

z.Fatmit Limaj, thekson se Projektrezoluta duhet të aprovohet dhe nuk ka qellim te konfrontohemi me administraten e UNMIK-ut as më Bashkësin Nderkobëtare por duhet gjetur mbështetje nga këta, dhe kjo Projektrezolut nuk është në dëm të minoriteteve.

z.Rada Trajkoviq kryetare e grupit parlamentar KP theksoi: -në qendrimin tonë kunder kesaj Projektrezolute e kemi shprehur më pare, por nese Kuvnedi do ta voton këtë, ne nuk do ta votojm, mendoj se Kuvendi nuk do te hy në konflikt më Bashkesin Nderkombëtare, dhe e perkrahim mendimin e z. Mihajl Shtajner.

z.Bujar Dugolli – në ëmer të grupit parlamentar AAK-es theksoi se kemi qen të gatshem ta marrim kete rezolut.

Ne e mbeshtesim dhe I ftoi deputetet qe te votojn per këtë.

z.Xhezair Murati në ëmer të grupit parlamentar të VTN-es, theksoi se territori I Kosovës është I pandashem dhe votoi për rezoluten.

z.Nexhat Daci – Pas ketyre diskutimeve të grupeve parlamentare, fton deputetet të votojn për Projektrezoluten.

Rezultati I votimit ishte :

PËR 85

KUNDER 0

APSTENIM 0

MINORITETI SERB NUK VOTOI

Z.Nexhat Daci ;Theksoi me lejoni te perfundoj seancen e kaluar dhe pas 15 minutash do te filloj mbledhja e re.

MBLEDHJEN E RE TË SEANCËS PLENARE E HAPI

z. Nexhat Daci, dhe kjo do ta ketë:

R E N D D I T E

1.Propozimi I AAK-së ,per Qeverine e Kosovës per pegaditjen e projektligjit per mbrojtjen e disa prodhimeve bujqësore, pika 26 e rregullores se perkohsheme e punes.

2.Debat lidhur me situaten ne Gjilan pas goditjes se termetit :

Të mirret vendimi mbi shtimin e numrit te antarëve ne komisione nga 9-11 antarë.

Rreth pikes se rendit te dites u ftuan z.Bujar Dugolli qe te paraqet project rezoluten te ofruar dhe I njëjti e lexoj dhe I dha arsyetimet e duhura.

Kryetari ne fjalen e tij theksoi se propozimi I AAK-së është I qelluar dhe është konsultuar edhe Kryesia e cila ka qen e mendimit te shkoj ashtu siq ka kerkuar vetë AAK-ja.

z.Tomë Hajdari ne fjalen e tij theksoi se propozimi I AAK-së është I qelluar dhe na ndihmon ne kete nga AAK-ja .

Unë jam edhe per nxjerrjen e ligjit te ketij llojit etj.

Në fund Kryetari hodhi ne votim kete project rezulut dhe e nejta është votuar nga te gjith deputetet.

Sa I perket pikes se dyë te rendit te dites Kryetari I Kuvendit dha arsyetimet dhe theksoi se kete qeshtje edhe Kryesia e Kuvendit e ka shqyrtuar ne mbledhjet e veta .

Pas saj fjalen e morri z.Nafije Gas.

Ajo diskutimin e vet e perqendroi ne dëmet qe jan shkaktuar Gjilanit me rrethin si ato subjective eshtu materiale te shkaktuara nga ana e termetit me daten 24.04.2002,dhe ne tërsi I paraqiti me shifra demet e shkaktuara.

z.Lubomir Stojanoviq deputet Kthimi ne diskutimin e tij dha sqarimet per pasojat dhe demet qe jan shkaktuar kesaj Komune dhe apeloj qe te ndihmohet ne sanimin e gjendjes se shkaktuar.

z.Nexhat Daci theksoi se ne mbledhjet e Kryesis se Kuvendit kemi vendosur qe ti ndihmojm ketij rajonit me pak mjete materiale financiare ne shum prej pesë milion euro dhe ato mjete nga suficiti I bugjetit të Kosovës per vitin 2002.

Kryetari e hodhi ne votim kete propozim te Kryesis se Kuvendit per tu votuar dhe u murr vendim qe keto mjete te dedikohen komunes se Gjilanit si ndihm financiare .

Ne fund kryetari kerkoi qe te votohet per shtimin e numrit antarve te Komisioneve te Kuvendit pre 9-11 antarë dhe arsya ishte qe te hyn edhe grupet e vogla politike ne Komisione ,keshteu qe propozimi I Kyresis se Kuvendit u miratua nga ana e deputetëve.

MBLEDHJA E SEANCËS PLENARE PERFUNDOJ NE ORA 12:30

SHËRBIMI JURIDIK